

**PKR.nr.655/15**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** - Gjyqtarja Shadije Gërguri, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha në lëndën penale kundër të akuzuarit B.K.për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për krime të rënda PP. I.nr.675/2015 të dt.13.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, me dt.22.08.2018 në prezencën e prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarit B.K. dhe mbrojtësit të tij av.B.C. sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpallë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I AKUZUARI**

**B.K.** nga i ati Sh. dhe e ëma D., e vajzërise J., i lindur me ... në P. ku edhe jeton rr. “T.”, ... nr...., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, menaxher në kompani ndërtimi “R.S.” me seli në P., gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr personal ....

### **ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** Nga data e pa caktuar e deri me dt: 27.06.2015, rreth orës 00:30, i pandehuri pa autorizim ka mbajtur armë, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli rutinor nga Policia e Kosovës , në fsh. K. është tentuar që të ndalet vetura e tipit “Landrover” ngjyrë e kuqe me targa ... e cila është ndaluar pastaj në rr. “... T.” në P. të cilën e drejtonte i pandehuri B.K.dhe gjatë kontrollimit i pandehuri ka pranuar se me veti ka poseduar armë të cilën e kishte hudhur në largim e sipër dhe së bashku me pjestarët e PK-së ka shkuar në vendin ku kishte hudhur revolen ku është gjetur dhe sekuestruar revolja me nr. serik D30164, prodhim Cekosllovak me një karikator dhe 7 fishekë të kal. 7.65mm,

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së,

Andaj gjykata në kuptim të neneve 3,4,41,42,46,73,74 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së.

## **E gjykon**

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 500 € euro, të cilën shumë i njëjti është i obliguar ta paguajë me katër (4) këste, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që 20 € (njëzet euro) të dënimit të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

Të gjykuarit B.K.i konfiskohet revolja me nr. serik D30164, prodhim Cekoslovak me një karikator dhe 7 fishekë të kal. 7.65mm, dhe e njëjta duhet të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 € (tridhjet) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP. I.nr.675/2015 të dt.13.11.2015 kundër të akuzuarit B.K.për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 22.08.2018 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sqarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet në barrë i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPK-së deklaroi se e pranoi fajësinë. Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësin dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me rastin e përcaktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, mosqenien i gjykuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale dhe po ashtu sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale pasi që gjykata nuk ka të dhëna që i njëjti është në ndonjë procedurë tjetër penale, qenien e tij familjar, mbajtës i familjës dhe baba i dy fëmijëve. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti

do të shërbej si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPK-së.

Vendimin mbi konfiskimin e armës, gjykata e mori konform nenit 374 par.3 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.655/15, të dt:22.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional,  
Driton Berisha**

**Gjyqtarja,  
Shadije Gërguri**

**Palët në procedurë heqin dorë nga e drejta në ankesë.**